

PROJEKTI PËR VLERËSIM DHE FORMA DREJTUESE

ORIGJINA E SHTETIT: KOSOVË

Titulli: Aftësia e të drejtave të fëmijëve në Kosovë në sistemin edukativ

Kërkuesi: Qendra për Arsim e Kosovës
Fakulteti Filologjik, kati I dytë
Sheshi "Nënë Tereze", pn.
Prishtinë, Kosovë

Emri i bartësit të projektit dhe pozita

Halim Hyseni
Koordinator i programit

Rekomandimi i projektit:
Kohëzgjatja e projektit

MAF 3-yr	X
MAF 2-yr	
Faza	
1-vit për mjete materiale	

Kontributi i rekomanduar: Si do të financohet projekti?

Sundry Domestic		Trocaire part	
Sundry International		Trocaire full	X
Eu		Trocaire NI	
Ireland Aid		Other (specify)	

Raporti i vlerësimit/ Ndikimi i projektit në të dhëna (cili është ndikimi i projektit në të dhëna? (shembujt më të rëndësishëm), duke u referuar në vlerësim, raporte dhe raporteve nga vizitat në teren).

Arsyeshmëria e projektit dhe prapaskena

(Si do të lidhet ky projekt me planin strategjik të shteteve përkatëse? Cili është çelësi i problemit dhe mundësia që ky projekt të adresohet?)

Lufta e cila mbaroi katër vite më parë ka prodhuar pasoja serioze për njerëzit e Kosovës. Shumë familje kanë humbur më të dashurit e tyre, infrastruktura përfshirë këtu edhe pasurinë e patundshme private është shkatërruar ose dëmtuar, poashtu edhe varfëria është

bërë një problem i madh në shoqëri. Urrejtja ndër etnike në mes shqiptarëve dhe serbëve ishte e madhe, dhe kthimi i popullatës shqiptare të cilët ishin strehuar, ka prodhuar siguri për popullatën serbe, shumica prej të cilëve e lanë Kosovën.

Një situatë jo e dëshiruar në terren për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve është pjesë përbërse që nga periudha e regjimit. Pika fillimore për UNMIK / OSCE / KFOR dhe shumë organizatave qeveritare dhe joqeveritare, ishte për të vërtetuar rezultatet kuptimplota të situatës. Kjo ka qenë e konfirmuar nga raporte të panumërta, të pavarura dhe kërkesa të bëra për Kosovën.

Parimi evident në këtë fushë nuk do të thotë që statusi për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve kanë arritur një standard të lartë. Në të kundërtën, raportet e pavarura, duke i përfshirë edhe ato të Ombudsperson-it, Këshillit për mbrojtjen dhe të drejtat e njeriut dhe Qendra për Arsim e Kosovës, demonstrojnë qartë se ka edhe më shumë për tu bërë që të arrihen standardet e duhura.

Ndër problemet kryesore që ndikojnë në çështjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve janë:

- Niveli i ulët i vetëdijes së publikut për të drejtat e njeriut dhe niveli i ulët i arsimit për të drejtat e njeriut
- Niveli i lartë i varfërisë së popullatës
- Trashëgimia afatgjate e konfliktit ndëretnik dhe mungesa e tolerancës ndëretnike
- Siguria sa i përket komunitetit serb, si dhe komuniteti shqiptarë në enklavat serbe
- Infrastruktura e pamjaftueshme ligjore
- Mungesa e strategjisë kombëtare për të drejtat e njeriut.

Sa i përket Bankës Botërore, vlerësimi i vobekërisë 2001, varfëria ka arritur në gjysmën e popullatës së Kosovës, por edhe një pjesë e vogël është relativisht afër varfërisë.

Një shqyrtim i cili është marrë nga KEC në shumën prej 2,237 nxënës, tregon rezultate të ngjashme, prej të cilave 56% kanë vështirësi t'i mbulojnë shpenzimet e shkollës, ushqimit, ruajtjes së shëndetit etj. Varfëria paraqet probleme të mëdha në fushën e të drejtave të fëmijëve, duke marrë parasysh pjesëmarrje të limituar në edukim, lëshimi i shkollës, arrijtjet e ulëta të edukimit në pengesat grupore, të cilat prodhojnë dallime duke u bazuar në popullsinë etnike dhe gjini.

Sidoqoftë pjesëmarrja apo regjistrimi për nxënësit shqiptarë dhe serb në shkollat fillore janë relativisht të kënaqur (97%), vetëm 76% të fëmijëve nga grupet tjera etnike janë të regjistruar në arsimin fillor. Balanca në këto raste është e evidente, sepse vetëm 69% të vajzave për dallim të djemëve 89% shkojnë në shkolla fillore. Për dallim nga kjo, 20% e fëmijëve të familjeve urbane me të ardhura të ulëta nuk përfshihen në arsimimin fillor. Padrejtësitë të cilat bëhen në edukimin e mesëm janë edhe më drastike. Për më pak se 50% e vajzave shqipëtare ishin regjistruar në shkollën e mesme në vitin 2000, për dallim nga minoriteti serb kjo përqindje ishte më pak se 40%. Duke bërë një krahasim të tillë me atë të varfërisë, vetëm 62% e fëmijëve nga familjet e varfëra janë të regjistruar në shkollën e mesme, në dallim prej 90% të fëmijëve të cilët nuk janë në varfëri.

Duke u bazuar nga këto studime për të drejtat e fëmijëve në shkollat e Kosovës, KEC organizoi një Konferencë të titulluar “Të drejtat e fëmijëve në sytë e fëmijëve të Kosovës“. Konferenca u mbajt më 30-31 Maj 2003 në Prishtinë ku morrën pjesë shumë ekspertë për të drejtat e fëmijëve nga Kosova, Sllovenia Kroacia, Maqedonia dhe Shqipëria, pastaj anëtarët e Kuvendit të Kosovës, poashtu edhe një numër i madh i mësimitdhënësve dhe nxënësve të Kosovës nga shkollat fillore që përfaqësojnë të gjitha komunitetet. Konferenca identifikoi problemet kyçe në këtë sektor dhe solli disa rekomandime për përmirësimin e gjendjes.

Në Konferencë u konkludua që të drejtat e fëmijëve në Kosovë shkelen në aspekte të ndryshme: fëmijët ofendohen dhe keqtrajtohen, ata duhet të bëjnë punë fizike për t'i sjellur të ardhura familjes etj. Përveq kësaj, fëmijët nuk janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, dhe kjo edhe më tepër mundëson shkeljen e këtyre të drejtave nga fëmijët tjerë dhe të rriturit. Polarizimet ndëretnike gjithsesi ekzistojnë edhe në mesin e fëmijëve: 90% e fëmijëve shqiptarë dhe boshnjakë mendojnë se komunitetet etnike në Kosovë gëzojnë të drejta të barabarta, ndërsa 97% të fëmijëve serb konsiderojnë se iu mohohen të drejtat elementare etnike.

Duke pasë parasysh atë që u tha më lartë, KEC tenton që të bëhen agjenci kombëtare për edukimin e mësimitdhënësve në fushën e të drejtave të njeriut, sepse ne besojmë fuqishëm se Kosova nuk do të ketë perspektivë dhe zhvillim demokratik pa i arritur standardet ndërkombëtare në respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe posaqërisht të drejtat e fëmijëve.

Ky projekt ka për qëllim të ndërtojë kapacitete të fuqishme vendore duke përfshirë mësimitdhënësit e aftë që do të merrshin në mënyrë efikase me qështjen e të drejtave të njeriut në institucionet arsimore. Ky është edhe njëri nga konkludimet e Konferencës rajonale që u mbajt në Prishtinë.

Problemet	Mundësitë
Niveli i ulët i vetëdijes së publikut për të drejtat e fëmijëve.	Mediat tregojnë interesim në këtë qështje. Rrjeti ekzistues i organizatave aktive në terren.
Mungesa e resurseve njerëzore për të iu adresuar qështjes së të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve në sistemin arsimor të Kosovës.	Kapaciteti ekzistues i aftësimin të mësimitdhënësve gjatë studimeve dhe gjatë punës në Kosovë. Përvoja ekzistuese në rajon.
Mungesa e strategjisë kombëtare e arsimimit për të drejtat e njeriut, posaqërisht të drejtat e fëmijëve.	Gatishmëria e tanishme e institucioneve Kosovare për zhvillimin e strategjisë kombëtare për edukim në të drejtat e njeriut si pjesë e strategjisë për zhvillimin e resurseve njerëzore në nivel kombëtar.
Korniza legale dhe institucionale për adresimin efikas të qështjes së të drejtave të fëmijëve.	Procesi i vazhdueshëm i hartimit të kornizës së re ligjore dhe institucionale për Kosovën.

Rezultatet e ulëta në arsim të disa grupeve (Romë, Ashkalinjë, Egjiptijan, të varfër, të traumatizuar, jetimëve, femrave, etj)	Klasët e bashkangjitura dhe arsimin e vazhdueshëm për komunitete të caktuara. Fondacionet nga Banka Botërore ngriten në nivel Kombëtar për adresimin e kësaj qështje.
Përfshirja e ulët e fëmijëve në arsimin parashkollor (vetëm 9% e grup moshave).	Edukimi parashkollor në bazë në komunitet. Zgjerimi i rrjetit ekzistues të institucioneve parashkollore. Hapja e klasëve parashkollore në shkollat fillore.
Mostoleranca në mes të komuniteteve etnike.	Vazhdimi i dialogut në mes të autoriteteve të Kosovës dhe Serbisë, dhe në mes të komuniteteve etnike në nivel vendi.
Qështja e të drejtave të njeriut nuk përfshihet në mënyrë adekuate në planprogramet shkollore e as në programet për përgatitjen e mësimdhënësve.	Ndryshimet e vazhdueshme në planprogramet shkollore dhe në programet për përgatitjen e mësimdhënësve. Përkushtimi i autoriteteve që të pajtohen me principet e EDC.

Grupet e Fokusuara

(Si do të participojnë grupet e fokusuara për planifikimin e këtij projekti? Kush janë grupet e fokusuara? Sa komunitete ose sa njerëz do të kenë përfitim direkt?) Ideja për këtë projekt erdhi që nga Konferenca e mbajtur në Prishtinë më 30-31 Maj, e quajtur “Të drejtat e fëmijëve në sytë e nxënësve të Kosovës”.

Duke u bazuar që më parë në udhëheqjen e analizës, Konferenca ka mbërritur konkluzione të sigurt, disa prej të cilave janë pjesë përbërëse për këtë projekt. Pavarësisht nga ekspertët nga Kosova për të drejtat e fëmijëve dhe nga regjioni, 30 arsimtarë, nxënës dhe zyrtarë nga shkollat e Kosovës, morrën pjesë në Konferencë, së bashku me përfaqësues nga Qeveria e Kosovës.

Qëllimet e përgjithshme: (Përcaktoj qëllimet e përgjithshme në terme në nivelet më të larta të arritshmërisë së projektit).

Për t’i avansuar të drejtat e fëmijëve në Kosovë duke ndërtuar kapacitete lokale në marrëveshje me të drejtat e fëmijëve në sistemin edukativ dhe duke sjellur rrjedhje të lartë për të drejtat e fëmijëve në rradhë të parë, politike.

Komponentet dhe objektivat	Aktivitetet (Lista e aktiviteteve të projektit që ndërlidhen me objektivat, të sigurohet se aktivitetet do të kontribuojnë në arritjen e objektivave)	Indikatorët (Të zhvillohen indikatorët duke bërë pyetje, se si do të dimë që aktivitetet janë përbushur dhe janë të suksesshme)
----------------------------	--	--

1. Ndërtimi i kapaciteteve trajnuese vendore	<p>1.1 Përgatitja për programin trajnues për trajnimin e Trajnerëve</p> <p>Sqarim:Programi trajnues për trajnimin e Trajnerëve do të zhvillohet nga ekspertët nga Kosova dhe Rajoni. Programi trajnues do të parasheh kriteret e certifikimit për trajnerët e ardhshëm dhe do të jetë mjaft i kuptueshëm që do të garantojë cilësi për trajnimet vijuese. Punëtoritë (workshop) do të përqëndrohen në përmbajtje si dhe në qështjet metodologjike.</p>	Programi trajnues dhe materialet për trajnim egzistojnë
	<p>1.2 Trajnimi i Trajnerëve për të drejtat e fëmijëve</p> <p>Sqarim: do të bëhet selektimi i 50 mësimitdhënësve të dalluar (edukatorëve) nga 7 Qendrat Rajonale të Kosovës dhe të cilët do të vijojnë 10 ditë trajnim gjatë një kursi tre mujor. Ne do të kërkojmë ata mësimitdhënës të cilët tregojnë interesim dhe aftësi që të bëhen trajner. Në fund të trajnimit pjesëmarrësit do të marrin cetifikata duke u bazuar në meritat e tyre dhe në kriteret.</p>	Së paku 30 mësimitdhënës të trajnuar janë të certifikuar si trajner dhe janë të gatshëm të marrin pjesë në aktivitetet e vazhdueshme të projektit
	<p>1.3 Përgatitja e programit të trajnimit dhe e doracakut për trajnimin e mësimitdhënësve (edukatorëve)</p> <p>Sqarim: Ekspertët nga Kosova dhe Rajoni së bashku me praktikantët e rinjë do të përgatisin programin për trajnimin e mësimitdhënësve si dhe doracakun për trajnim.</p>	Programi trajnues dhe doracaku do të shqyrtohet dhe rekomandohet nga dy persona të pavarur, ekspertë në fushën e trajnimit dhe/ose të drejtave të fëmijëve.
	<p>1.4 Mbështetja e zhvillimit të planprogramit për të drejtat e fëmijëve në Fakultetin e Edukimit. Fakulteti i Edukimit është përgjegjës për përgatitjen e mësimitdhënësve në Kosovë</p> <p>KEC do të ketë parasysh ndihmën që do t'i ofroj Fakultetit të Edukimit në hartimin e planprogrameve për të drejtat e fëmijëve në mënyrë që të sigurojë gjeneratat e reja të mësimitdhënësve të jenë të përgatitur dhe edukuar mirë në këtë fushë.</p>	Planprogrami për të drejtat e fëmijëve për Fakultetin e Edukimit do të zhvillohet dhe do të jetë i gatshëm për implementim.
2. Ndërtimi i kapaciteteve për këshillime të drejtave të fëmijëve në shkollat fillore të Kosovës	<p>2.1 Përgatitja e orarit për trajnim</p> <p>Sqarim: KEC në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit do të përcaktojë orarin që do të përcaktojë dinamikën e trajnimeve. Do të selektohen nga 1-3 mësimitdhënës nga secila shkollë fillore e Kosovës që do të merren me qështjen e të drejtave të fëmijëve në shkollë. Këta mësimitdhënës do të jenë përgjegjës për trajnimin e këshillimin e kolegëve të tyre, si dhe do të merren me situata të përditshme që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve në shkollat e tyre.</p>	Një orar mjaft efektiv do të hartohet dhe aprovohet nga Ministria.
	<p>2.2 Të selektohen pjesëmarrësit e potencialit të trajnimit</p>	Gjatë periudhës tri vjeçare do të selektohen 1,500-1,700

	<p>Sqarim: Selektimi do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me udhëheqësit e shkollave dhe Zyrtarët Rajonal të Arsimit në mënyrë që të sigurohemi që janë zgjedh njerëzit të cilët kanë vullnet dhe aftësi të merren me qështjen e të drejtave të fëmijëve.</p>	pjesëmarrës potencial
	<p>2.3 Trajnimi i konsulentëve të shkollave për të drejtat e fëmijëve</p> <p>Sqarim:Gjatë periudhës tri vjeçare do të trajnohen përafërsisht 1,500 mësime të cilët do të veprojnë si këshilldhënës për të drejtat e fëmijëve në shkollat e Kosovës. Ata do t'i nënshtrohen një trajnimi 5 ditor që do të ndahet në dy pjesë. Trajnimi do të udhëheqet nga trajnerët kosovarë të cilët në fillim do të kenë nevojë për mbështetje nga ekspertët në formë të këshillave.</p>	Personat që përfundojnë programin do të jenë të aftë të merren me qështjen e të drejtave të fëmijëve në shkollat e tyre.
3. Përmirësimi i gjendjes së të drejtave të fëmijëve në shkollat e Kosovës	<p>3.1 Themelimi i Komiteteve për të drejtat e fëmijëve të gjitha shkollat fillore të Kosovës.</p> <p>Sqarim: Këshilluesit për të drejtat e fëmijëve të trajnuar nga KEC do të jenë përgjegjës për themelimin e Komiteteve për të drejtat e fëmijëve në shkollat e tyre. KEC, në bashkëpunim me sektorët e ministrive përkatëse, do të hartojë parimet e përgjithshme për funksionimin e komiteteve të tilla.</p>	Komitetet për të drejtat e fëmijëve ekzistojnë dhe veprojnë në të gjitha shkollat fillore të Kosovës.
	<p>3.2 Monitorimi i drejtave të fëmijëve në shkolla.</p> <p>Sqarim: KEC do të zhvillojë një metodologji të monitorimit që do lejojë mbledhjen e informatave rreth të drejtave të fëmijëve në të gjitha shkollat e përfshira. Monitorimi do të ofrojë informata rreth efekteve të intervenimit tonë si dhe do të lejojë që vet programi trajnues dhe metodologjia e monitorimit të përshtaten.</p> <p>Përqëndrimi më i madh do të jetë në grupet më të përbuzura të fëmijëve (fëmijëve të lënë pas dore) , duke përfshirë edhe një përqëndrim hulumtues në këto grupe.</p>	Monitorimi tregon efekte pozitive të intervenimit
4.Ngritja e vetëdijes për të drejtat e fëmijëve	<p>4.1 Mbështetja e diskutimeve në tryeza të rumbullakëta dhe debateve për të drejtat e fëmijëve.</p> <p>Sqarim: KEC do të organizojë diskutime në tryeza të rumbullakëta dhe debate me pjesëmarrës të palëve të interesuara dhe me media që do të fokusohen posaqërisht në qështjen e të drejtave të fëmijëve. Disa nga këto debate do të organizohen edhe në media elektronike të cilat do të emitohen.</p> <p>Gjatë zbatimit të projektit, KEC do të bëjë projekte që të ngris fonde nga burime tjera (p.sh.nga programi lindje-lindje SOROS) për dy ngjarje rajonale që</p>	Pjesëmarrja e gjërë e palëve të interesuara në diskutime dhe debate

	ndërlidhen me qështjen e të drejtave të fëmijëve. Përvojat kanë treguar që ngjarjet e tilla mund ta sjellin qështjen e të drejtave të fëmijëve në fokus të agjendës.	
	4.2 Botimi/përkthimi i materialeve që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve në shkolla . Sqarim: Kontributi i mediave, posterat, broshura për prindër dhe fëmijë, punëtori (workshop), etj.	Materiale cilësore do të prodhohen dhe propagandohen.
5. Strategjia nacionale për të drejtat e fëmijëve	5.1 Mbështetja e pjesëmarrjes në procesin e planifikimit të strategjisë Sqarim: KEC ka një përvojë të madhe që të ndihmojë në procesin e planifikimit të strategjisë nëpërmes participimit. Planifikimi duhet të organizohet duke marrë pjesë të gjitha palët e interesuara. Strategjia do të shkruhet nga ekipi i KEC në bashkëpunim me përfaqësuesit e Qeverisë. Nëse do të sigurohen fonde nga burime tjera (Programi Lindje- lindje SOROS) procesi i planifikimit të strategjisë do të përfshijë një numër udhëtimesh studimore të palëve kosovare në vendet tjera të rajonit.	Zhvillohet korniza e strategjisë për një qasje afatgjate
	5.2 Mbështetja e diskutimeve rreth strategjisë Sqarim: Ka mënyra të ndryshme për të ndihmuar diskutimin rreth strategjisë, por mënyra më e mirë do të ishte organizimi i ngjarjeve të ndryshme rajonale në të cilat do të prezantohen dhe diskutohet strategjia me pjesëmarrjen e kosovarëve dhe ekspertëve nga rajoni. Në këtë rast duhet të sigurohen fonde nga burime tjera(Programi lindje-lindje SOROS).	Pjesëmarrja e gjërë e palëve të interesuara në diskutim

Plani i veprimit

Rreziqet

(Cilat janë rreziqet kryesore të cilat do të veprojnë direkt për suksesin e këtij programi? Identifikoni rreziqet duke i lidhur rreziqet me objektivat dhe qëllimet e përgjithshme.)

Nga aktivitetet deri te pjesët përbërëse/ objektivat

Kurrikuli i të drejtave të fëmijëve nuk do të zbatohet nga Fakulteti i Edukimit. Vendimi final mbështetet nga Senati i Universitetit.

Trajnimi i këshilltarëve për të drejtat e fëmijëve në shkollat fillore mund të jetë i prekur nga ndryshimet në administratën edukative në nivelet kombëtare.

Në shkollat e sigurta, Komitetet për të drejtat e fëmijëve nuk do të ishin të themeluara për arsye të kapacitetit të limituar të marrëveshjes me këto probleme.

Nga pjesët përbërëse/ Objektivat dhe qëllimet e përgjithshme

Sistemi i edukimit mund të ketë mungesë nga këshilltarët për të drejtat e fëmijëve, posaqërisht për mungesën për të pakësuar detyrat e mësimit ose t'i shpërblejmë ata me qëllim që t'i lejojmë për më shumë aktivitete për të drejtat e fëmijëve.

Qeveria mund të mos kënaqet me këtë problem për të drejtat e fëmijëve në edukim me prioritet të lartë.

Cross Cutting Issues
Development Rights

Politike

(Si do t'a fuqizoj projekti kapacitetin për mbrojtje/ pohimet për të drejtat në nivelin e ulët dhe të lartë?)

Projekti ndërton kapacitet për mbrojtje për të drejtat e fëmijëve, që të dy nivelet të ultin dhe të lartin.

Këshilltarët e udhëhequr të komiteteve, për të drejtat e fëmijëve duhet të jenë në gjendje të mirren vesh me problemet e të drejtave të fëmijëve në nivelin e shkollës. Në anën tjetër, nga ndikimi i kurrikulit të Fakultetit të Edukimit, merr përsipër vetëdijen e ngritjes së aktiviteteve dhe nga zhvillimi i strategjisë kombëtare sjell probleme në të drejtat e fëmijëve që në fillim të rendit të ditës në nivele të larta.

Ekonomike

(Si bën projekti ngritje të shkathtësive, p.sh. toka, kredia, shërbimet, punët,?)

Sociale

(Si e fuqizon projekti strukturën e komunitetit, participimin dhe shkathtësitë në zhvillimin e njeriut?)

Respekti për të drejtat e fëmijëve në sistemin edukativ në Kosovë, duhet të kontribuojë në demokratizimin e qytetarëve, tolerancën dhe respektin për shumëllojshmëri në shoqërinë kosovare.

Kulturore

(Si fuqizohet sistemi i diturisë vendase, teknologjia e përshtatshme dhe kultura minoritare?)

Mjedisi

(Cilat janë ndikimet pozitive ose negative për mjedisin në këtë projekt?)

Ndikimet gjinore

Nevojat gjinore praktike- Si do të përkrahë drejtësinë ky projekt në mes të burrave dhe grave në përdorimin e nevojave praktike si uji, ushqimi, rritja e të arrdhurave?

Nevojat strategjike gjinore- Në ç'farë mënyre do të iu ndihmojë ky projekt grave që të bëjnë të ardhura strategjike në termet e hyrjes së shkathtësive, të marrin më tepër vendime dhe të kontrollojnë vet jetën e tyre?

Në ç'farë mënyre do të jenë të inkuadruar burrat për t'i përkrahur këto përpjekje?

3.4 Lidhmëritë

Si do të lidhet ky projekt me organizatat joqeveritare dhe punën e rrjetit në sipërfaqe?

Projekti do të jetë i lidhur ngushtë me organizatat joqeveritare dhe donatorë të agjensive të ndryshme të cilët i kanë adresuar problemet e të drejtave të fëmijëve në vitet e fundit. Ne shohim mundësinë të bashkëpunojmë me UNICEF, Catholic Relief Services (CRS), Finish Human Right Project, Council for Defence of Human Rights, Save the Children UK, dhe institucionet tjera të cilat janë të interesuara në këtë temë.

Si do të lidhet ky projekt me planet qeveritare ose strukturën ose zhvillimet tjera në akademi, media dhe sektore private?

Qeveria e Kosovës ka treguar interes të qartë në ngritjen e situatës për të drejtat e fëmijëve duke marrë pjesë vazhdimisht në iniciativat ekzistuese, poashtu edhe duke caktuar detyra konkrete në sektoret e Ministrisë.

A do të lidhet ky projekt edhe me regjionet e gjëra ose me përkrahjet internacionale apo me iniciativat rrjetore?

Ideja e Konferencës për të drejtat e fëmijëve e cila u organizua në Maj 2003 ishte që të mësohet eksperiencia ekzistuese në regjion. Ky projekt nuk do të jetë i përjashtueshëm.

Kontakte të përhershme do të kemi edhe me Qendrën Shqiptare për të drejtat e njeriut me qëllim që të marrim eksperiencë prej tyre.

Së pari projekti do të filloj, kontakte do të kemi edhe me institucionet tjera duke zbatuar iniciativa të ngjajshme në regjion.

Zbatimi dhe Menagjimi Informativ
Struktura e Menagjimit dhe marrja e vendimeve

(Ç'farë është struktura organizative? P.sh. BoD, mgmt dhe kryesia në rradhë të dytë.
Ju lutemi na i jepni detajet për përgjegjësinë e përbajtjes së projektit)
Projekti do të hartohet nga ky staf:

POZITA	Përshkrimi i punës	Kohëzgjatja e të punësuarve
Drejtor i projektit	Menagjimi i projektit në nivelet kombëtar	36 muaj
Ndihmës i projektit	Asistimi i menagjerit të projektit/ dokumentimi i projektit	33muaj
Stafi regjional i përbërë nga 7 persona	Përkrahjet logjistike të konsulentëve nëpër shkolla për trajnimin e tyre për të drejtat e fëmijëve. Përkrahja e themelimit të këshillit për të drejtat e fëmijëve. Vështrimi.	168 muaj I tërë stafi së bashku
Llogaritari i projektit		12 muaj

Komiteti drejtues, i përbërë nga anëtarët e KEC, autoritete arsimore dhe institucionet në partneritet do të takohen dy herë në vjet të përsërisin rezultatet e monitoruara të projektit dhe të marrin vendime në pyetjet strategjike, posaqërisht sa i përket masave në përbajtjen e projektit në sistemin arsimor të Kosovës.

Drejtori i Bordit të KEC dhe Drejtori Ekzekutiv i KEC do t'i shqyrtojnë rregullisht raportet e menagjimit të projektit, dhe do t'i përkrahin dhe udhëzojnë ata kur është e duhur

Kapaciteti Organizativ

(Cilat janë forcat për përmirësimin e organizimit në këtë fushë? A është zhvilluar ndonjë plan për zhvillim organizativ që iu adresohet qështjeve të rëndësishme? Si dhe kur është zhvilluar?)

KEC ka zhvilluar një strategji tri vjeçare me mision për të ofruar mundësi për zhvillim profesional dhe sjell informata përkatëse për stafin arsimor dhe për popullatën.

Kështu KEC këshillon të ndihmojë sistemin arsimor duke ndërtuar kapacitet te mësuesit dhe administratorët, duke vërtetuar zbatimin në kryerjen e punës së tyre.

Llogaridhënia

(A janë raportet financiare të prodhuara rregullisht dhe në standarde të pranueshme? A ka organizata sistem financiar e cila e zhvillon transparencën? Çka është financimi vjetor? Në ç'farë qarkullimi janë të prodhuara raportet?)

KEC kryesisht i drejton fondet donatore, dhe duhet të bindet me lajmet deri në një masë të duhur nga donatorët e ndryshëm. Në përgjithësi raportet tona rrëfyese dhe financiare

janë të pranueshme nga partnerët tanë. Për çdo vjet raportet janë bërë të përdorshme për Bordin e Drejtorëve, dhe të aprovuara po nga ai person. Raportet financiare janë në shqyrtim çdo vit nga kompani të pavarura, dhe raporti dorëzohet në UNMIK/NGO Liaison Office, e cila është përgjegjëse në aktivitetet për monitorimin e organizatave joqeveritare. Viti financiar takohet me vitin kalendarik. Shënimet financiare janë në EUR.

Mekanizmi i Vlerësimit

(Ç'farë mekanizma monitorues internacional ekzistojnë brenda në organizatë? A janë pajtuar planet për vlerësime me partnerët e projektit? Ç'farë metodologjie do të përdoret?)

Mekanizmi i vlerësimit është ndërtuar në strategjinë e KEC. Vlerësimet formale të projektit janë në shikim së paku një herë në vit dhe zakonisht në mënyrë të pjesërishme.

Vizitat dhe Monitorimi

(Sa shpesh do të jetë i vizituar ky projekt nga stafi Trocaire? Ç'farë mekanizma të tjerë monitorues do të përdorni ju që të siguroni një projekt efektiv?)